



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi I Komunës



12 Nr. 353/01-28780 dt. 30/07 .2020

Bazuar në nenin 11,12, dhe 40, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34,pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, të nenit 12, pika12.1 dhe pika 12.2, nenit 14 pika 14.1 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me date 30.07.2020, miratoi këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e Çerdhes në Komoran.

Neni 1.

Vendimi për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e Çerdhes në Komoran, e cila është pronë e Komunës së Drenasit, dhe ka këto karakteristika dhe është në zonën kadastrale në Komoran, në pjesën e ngastrës kad. Nr. 50/1, me $S= 13240m^2$, me kulture tokë ndërtimore.

Neni 2.

Qëllimi për caktimin e këtij lokacioni ka të bëjë me realizimin e Projektit për ndërtimin e Çerdhes në Komoran, ku nga parcela e lartë cekura do të shfrytëzohet sipërfaqja si në vijim: Nga parcela 50/1, me $S=13240 m^2$, sipërfaqja e propozuar që do të mirret në shfrytëzim është $3000 m^2$.

Neni 3.

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale dhe pronësore, që nevojiten për regjistrimin në RDPP.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Drenasit.

Neni 5.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kopja e planit dhe Çertifikata e njësisë kadastrale.

Neni 6.

Me këtë Vendim do të njoftohen organët kompetente të Komunës së Drenasit.

Neni 7.

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Drenasit si dhe nënshkrimi nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatesë;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit